

## **Dr. Endrit Musaj**

Ka përfunduar studimet universitare me kohë të plotë 1997 – 2001, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, dega Histori. Në vitin 2011, përfundon studimet në sistemin “Master i Nivelit të Dytë” në Histori. Në vitin 2017 merr titullin Doktor Shkencash në fushën e Historisë, në Universitetin e Tiranës.

Që nga viti 2004 dhe në vazhdim, punon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, fillimisht si administrator dokumentesh, më pas specialist arkivist, përgjegjës i sektorit Audiovizual, i sektorit të Komunikimit, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit, Dokumentacionit dhe Shërbimeve të Publikut dhe aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimeve. Ka ndjekur trajnime në fushën arkivore të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Pjesëmarrës në konferenca shkencore me temë historike dhe arkivore brenda dhe jashtë vendit. Autor i studimeve botuar në fletoren “Arkivi Shqiptar” të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Vjetarit të Agjencisë së Arkivave të Kosovës.

Lektor (part time) në fakultetin Histori-Filologji në Univeristetin e Tiranës, në masterin Arkivistikë.

## **Dr. Lorenc Agalliu**

Ka përfunduar studimet e larta në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës (1997-2001). Në vitin 2010 ka kryer Master Shkencor në Histori. Në vitin 2016, ka mbrojtur titullin Doktor i Shkencave në fushën e Historisë, në Universitetin e Tiranës.

Që nga viti 2001 punon pranë Drejtorisë e Përgjithshme të Arkivave. Gjatë kësaj periudhe ka punuar në sektorë të ndryshëm; 2001-2006 specialist/arkivist; 2006-2009 Drejtor i Arkivit Shtetëror Vendor Durrës; 2009-2019 specialist/arkivist; 2019-2021 Përgjegjës Sektori në Sektorin e Përpunimit të Dokumentacionit të ASHV-ve.

Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Ka kryer disa trajnime në fushën e arkivistikës, të organizuara nga DPA Tiranë dhe arkivat e vendeve të ndryshme të Evropës. Ka kryer Stazhin Teknik Ndërkombëtar të Arkivave në Arkivin Nacional të Parisit, Francë (prill-qershor 2004). Ka marrë pjesë në projekte të ndryshme që lidhen me fushën arkivore.

Pjesëmarrës në zbatimin e Projektit STAR I, Document Management System, Protocol and Archives Inventory dhe trajnues në projektin STAR-2, “Për trajnimin e punonjësve të Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore”.

Referues në disa konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe autor i një sërë artikujve shkencorë me temë historike dhe arkivore, të publikuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Autor i Monografisë shkecore me titull “Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore” ISBN 978-9928-267-290

Që nga viti 2014 e në vazhdim lektor (part time) në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, në Departamentin e Shkencave Politike.

## **Ylber Ramaj**

Ka ndjekur studimet e larta në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dega; Histori-Gjeografi, 2002 - 2006. Në korrik të vitit 2008, ka filluar punë si specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, duke punuar në sektorë të ndryshëm. Në shkurt të vitit 2014, emërohet inspektor në Drejtorinë e Inspektim-Trajnimit, pranë DPA-së, funksion të cilin e ushtroi deri në korrik 2019, ku më pas, emërohet përgjegjës sektori në Drejtorinë e Inspektimit dhe Trajnimeve. Ka ndjekur dhe marrë pjesë në disa seminare trajnuese të zhvilluara kryesisht, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe Inspektorati Qendror. Gjithashtu, si specialist me një eskperiencë 14 vjeçare në fushën arkivore, është angazhuar edhe si lektor në seminarët trajnues, të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në bashkëpunim edhe me (ASPA) Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, duke trajtuar temën: “Evidentimi i dokumenteve në sekretari. Mjetet e evidentimit”, por edhe tema të tjera për punën arkivore.

## **Theodhora Lena**

Ka përfunduar studimet e larta në degën Mësuesi pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin “Eqrem Cabej”, Gjirokastër (2006-2009). Në vitin 2014, përfundon studimet në sistemin Master në Arkivistikë, në fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në Universitetin e Tiranës.

Që nga viti 2007 dhe në vazhdim, punon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, fillimisht si specialiste arkiviste e aktualisht si inspektore qendrore në Drejtorinë e Inspektimit dhe Trajnimeve.

Ka ndjekur trajnime në fushën arkivore të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Lektore në seminarët teoriko-praktike që organizon Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në temën vlera e ruajtjes së dokumenteve. Sekretare e Komisionit Qendror të Ekspertizës.